



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË
KRYETARI

VENDIM

Nr. 223, Datë 27. 04. 2021

**“Për disa shtesa dhe ndryshime në
Rregulloren e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot.,
datë 24.04.2020”**

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për Kinematografinë”, i ndryshuar, pikën 4, të Nenit 5, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, si dhe Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, me qëllim përmirësimin e punës në funksion të rritjes së cilësisë së projekteve kinematografike në konkurim, si dhe përditësimin e disa procedurave me ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore të hyra në fuqi kohët e fundit,

V E N D O S A:

I. Në Rregulloren e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot., datë 24.04.2020, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2, nënkapitulli I, Kapitulli I, “Financimi i projekteve kinematografike”, bëhet si më poshtë:

“2- Financimi i projekteve kinematografike, për prodhimin e filmave në kategoritë:

- a. Projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë, vepër karriere;*
- b. Projekte për filma artistikë me metrazh të gjatë- vepër e parë;*
- c. Projekte për filma artistikë me metrazh të shkurtër;*
- d. Projekte për filma dokumentarë;*
- e. Projekte për filma të animuar.”.*

2. Pas pikës 2 të nënkapitullit I, Kapitulli VI, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1- Regjistrimi vjetor i producentëve/distributorëve në QKK kryhet nëpërmjet platformës e-albania.”.

3. Pas pikës 2 të nënkapitullit III, Kapitulli VI, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Projektet për film artistik me metrazh të gjatë-vepër e parë do të konkurojnë për financim, duke kaluar më parë fazën e zhvillimit të projektit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 8, Kapitulli VIII.”.

4. Titulli i pikës 8, të Kapitullit VIII, bëhet si më poshtë:

“8. PROJEKTE PËR ZHVILLIM PËR FILMA ARTISTIKË ME METRAZH TË GJATË-VEPËR E PARË”.

5. Në Paragrafin DOKUMENTACIONI I DETYRUESHËM PËR APLIKIM të pikës 8, të Kapitullit 8, pas pikës 6, shtohet pika 6/1, si më poshtë:

“6/1. Konfirmim që projekti ka fituar mbështetje financiare për zhvillim në Qendër, apo ente të tjera publike dhe private, apo është selektuar/kualifikuar për zhvillim në të paktën një forum, Lab, workshop, etj., të organizuara nga institucione publike, apo të pavarura të njohura ndërkombëtarisht.

6. Në çdo rast tjetër ku në këtë Rregullore është përdorur termi “Film artistik me metrazh të gjatë - Vepër e parë & e dytë” do të nënkuptohet “Film artistik me metrazh të gjatë - Vepër e parë”.

II. Ky vendim hyn në fuqi datën e nënshkrimit dhe bëhet pjesë e Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 155 Prot., datë 24.04.2020.

III. Ngarkohet Drejtoria e Projekteve të bëjë njoftimin përkatës në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë.



Eduart MAKRI

Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr.77, Tiranë

Tel/Fax. 378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al

www.nationalfilmcenter.gov.al